



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 377/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Fikrim Damka nga radhët e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), paraqitur kundër vendimit të rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja, me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me datën 02.07.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fikrim Damka nga radhët e subjektit politik KDTP.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatin për deputet nga koalicioni LDK-AKR në Vendvotimin 2004A/07R ;

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve në Vendvotimin si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

**IV. Visar Morina** me nr. të letërnjoftimit 1016284862, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit 2004A/07R, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 30.06.2017, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Fikrim Damka nga radhët e koalicionit LDK-AKR, me të cilën pretendon se nga momenti i shpalljes së rezultateve nga KQZ-ja me datën 29.06.2017 në ora 14:00 në Prizren, në shkollën “Motrat Qiriazit”, në kutin e votimit nr. 2004A/07, vërehet se rezultatet nuk përputhen me rezultatet të cilat i posedojnë.

Parashtruesi i ankesës thekson se, nga Formulari i Rezultateve të Kandidatëve FRK është bërë lëshim, pasi që votat e kandidatit Fikrim Damka janë shënuar gabimisht, prandaj sipas raportit të vëzhguesit nga radhët e subjektit politik KDTP, në këtë kuti të votimit numëri i

votave të kandidatit Fikrim Damka figuron 81, mirëpo kryesuesi i vendvotimit VV 2004/07 ka regjistruar në formular vetëm 5 vota me të cilën edhe kandidati Fikrim Damka ka pasur numrin 5.

Parashtruesi i ankesës në cilësi të provave materiale ankesës i ka bashkangjitur Formularët e Rezultateve të Kandidatëve FRK .

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme* “

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

#### **ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe pas hetimit të bërë gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, për faktin se pas hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutinë e Votimit 2004A/07R është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidati Fikrim Damka nr. 5 nga radhët e subjektit politik KDTP dega në Prizren, i ka 5 vota, në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i ankesës i posedon 80 vota të vlefshme.


Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkitazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit, për pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par. 3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par. 10 të LZP-së. Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës i janë regjistruar pesë vota në FRK, ndonëse pas hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 80 vota.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 377/2017 më datën 02.07.2017.



**Kryesuesi i Panelit**

**Ymer Hoxha**

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.